



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justininan 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/R/173/2012
24/10/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në 24 (njëzetekatër) kërkesat e identifikuar në pjesët A, B, C dhe E të listës së bashkangjitur, Komisioni,

vendos që

Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, e ka vërtetuar pronësinë për pronën e kërkuar, apo për pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në 7 (shtatë) kërkesat e identifikuar në pjesën D të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar pronësinë e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar, apo për pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(3) Në kërkesën Nr. 46039, të identifikuar në pjesën F të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar, apo për pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(4) Në 32 (tridhjetedy) kërkesat e identifikuar në paragrafët (1), (2) dhe (3) më sipër, me përjashtim të kërkesave nr. 08711, 34498, 38038 dhe 48729, Komisioni

urdhëron që

- (a) *Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;*
 - (b) *Çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri;*
 - (c) *Nëse çdo person i cili e ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona;*
- (5) *Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë për aq sa paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar; dhe*
- (6) *Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit prej bashkëpronarëve përkatës.*

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposeditim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposeditim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetenjë nga 22 deri 24 tetor 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 150 kërkesa për pronë banesore në seancën tridhjetë e një nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Tri kërkesa për pronë banesore, të cilat i ishin paraqitur Komisionit, u tërhoqën nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e një kërkesë banesore në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Përveç këtyre, Komisioni vendosi pesë kërkesa të cilat ishin ndërprerë me herët në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Gjithsej 151 kërkesa për pronë banesore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë lindur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

7. Ky vendim zbatohet për 32 kërkesa të cilat janë të regjistruara në pjesën A, B, C, D, E dhe F të listës së bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 119 kërkesave përfshihen në vendimet KPCC/D/R/174/2012 dhe KPCC/D/R/175/2012.

8. Gjithsej 29 nga 32 kërkesa të përfshira në këtë vendim nuk janë shqyrtuar më parë nga Komisioni, ndërsa tri kërkesat e mbetura kanë qenë subjekt i një vendimi të mëparshëm të Komisionit. Megjithatë, vendimi i mëparshëm në këto tri kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive ose për shkak të gabimeve tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë identifikuar pasi është marrë vendimi. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronës së kërkuar dhe korrigjimit të gabimeve të përpunimit. Dëshmitë dhe informacioni i ofruar nga palët përgjegjëse në kërkesë ose uzurpuesit aktualë të pronave të kërkuara janë marrë në konsideratë nga Komisioni në procesin e rivendosjes së kërkesave. Në kërkesat për të cilat vendimet e mëparshme janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar secilit paraqitës të kërkesës duke i informuar ata për gabimet e notifikimit dhe i ka informuar se kërkesa do të rivendoset

¹Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi I kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

pas notifikimit të saktë të pronës të kërkuar. Paraqitësit e kërkesës si dhe autoritetet e kadastrave përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

9. Në 31 nga gjithsej 32 kërkesat të cilat përfshihen në këtë vendim paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës pronësore. Në një kërkesë paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës për të drejtën e shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Të gjitha këto kërkesa janë për prona banesore përfshirë sipas rastit tokën e bashkuar. Ky vendim ka të bëjë me prona banesore, të cilat në kohën e notifikimit të tyre u konstatuan se nuk ishin tërësisht të shkatërruara.

10. Të 25 kërkesat e referuara në pjesët A, B, C dhe D të listës bashkangjitur këtij vendimi janë kërkesa pronësore jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit, në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079. Vendimet e marra për kërkesat që janë notifikuar pasaktësisht, janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave edhe për t'iu ofruar personave të cilët mund të kenë interes ligjor në pronë, mundësinë për t'ju përgjigjur kërkesës në bazë të nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse në pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur. Sekretaria Ekzekutive i ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme përfshirë edhe notifikimin fizik të pronave dhe/ose përmes notifikimit të pronave nëpërmjet publikimit në gazeta dhe gazeta zyrtare, përmes autoriteteve komunale vendore, gjykatave komunale, udhëheqësve vendorë të fshatit dhe përmes institucioneve të tjera përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionin e ofruar nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni konstaton se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat dhe cilindo person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronat e tilla sipas kërkesës së nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

11. Gjashtë kërkesat e referuara në pjesën E të listës së bashkangjitur si dhe kërkesa nr. 46039 e referuar në pjesën F të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala ose palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara kanë shprehur interes ligjor në pronat e tilla ("Pala përgjegjëse"), e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës në afatin prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 10.2 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

A. Kërkesa të miratuara

1. Kërkesat jokontestuese

12. Komisioni vëren se paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur lloje të ndryshme të dokumenteve në mbështetje të kërkesave për pronësinë, vendimet e trashëgimisë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme. Komisioni konstaton se vendimet e trashëgimisë dhe certifikatat për të drejtat e pronës së paluajtshme të cilat konfirmojnë një interes pronësor, në të vërtetë përbejnë prova të pronësisë. Dokumentet e tjera të paraqitura nga paraqitësit e kërkesave përfshirë fletët poseduese dhe kontratat që përfshijnë transaksione pronësore krijojnë një supozim të kundërshtueshëm të pronësisë. Kërkesat e identifikuar në

pjesët A, B, C dhe D të listës së bashkangjitur nuk janë kontestuese dhe nuk është marrë e as nuk është kërkuar asnjë provë nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio* e cila do të kundërshtonte supozimin e pronësisë. Rrjedhimisht, Komisioni konstaton se dokumentet e paraqitura provojnë të drejtën pronësore të paraqitësve të kërkesave për pronat e kërkuara. Këto dokumente janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vlefshme dhe përkatëse.

13. Në dhjetë kërkesat pronësore të identifikuara në pjesën A të listës së bashkangjitur, paraqitësit e kërkesave kanë paraqitur kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Duke pasur parasysh konstatimet e Komisionit në paragrafin 12 më sipër, këto kërkesa duhet të miratohen.

14. Në një kërkesë të identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Neni 1 i Urdhërësës Administrative e miratuar me ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si “Anëtar i Bashkësisë Familjare” përfshihen “bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t’i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë qëndruar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore.” Paraqitësi i kërkesës bie në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare. Rrjedhimisht, duhet të miratohet vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartësit të së drejtës pronësore në këtë kërkesë, ashtu si përcaktohet më sipër.

15. Në shtatë kërkesat e identifikuara në pjesën C të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesës nuk kanë qenë bartës të së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por kanë paraqitur prova se më pas kanë trashëguar të drejtën përkatëse të pronësisë me anë të trashëgimisë. Paraqitësit e kërkesës duhet të konsiderohen se kanë trashëguar të gjitha të drejtat që i takojnë pronarit, duke përfshirë të drejtën për të bërë kërkesë për konfirmimin e pronësisë dhe të posedimit në këtë procedurë. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të miratohen.

16. Në shtatë kërkesat e identifikuara në pjesën D të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesës nuk kanë qenë bartës të së drejtës pronësore në datën e humbjes së posedimit të pronës së kërkuar, por pohon të kenë fituar të drejtën pronësore. Në secilën prej këtyre kërkesave paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar se ai është anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Megjithatë, nuk është paraqitur vendim i vlefshëm mbi trashëgiminë apo ndonjë dëshmi tjetër e dokumentuar nga paraqitësit e kërkesave që do të vërtetonte ndonjë nga paraqitësit e kërkesave si trashëgimtarë të pronës së kërkuar dhe as Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të gjejë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, duhet të miratohet vendimi i cili konfirmon të drejtën pronësore në dobi të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore në këto kërkesa ashtu si është përcaktuar më sipër. Vendimi i Komisionit në lidhje me shtatë kërkesat e identifikuara në pjesën D të listës së bashkangjitur nuk cenon vendimin e gjykatave kompetente për mënyrën se si trashëgimtarët do të trashëgojnë të drejtën pronësore nga i ndjeri.

2. *Kërkesa kontestuese*

17. Gjashtë kërkesat e identifikuara në pjesën E të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala ose palët që kanë uzurpuar pronat e kërkuara kanë shprehur interes ligjor në pronat e tilla (“Pala përgjegjëse”), e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës në afatin prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 10.2 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me

Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme të procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

18. Megjithatë, për të gjitha këto kërkesa, në bazë të shqyrtimit të dëshmimeve që ka në dispozicion, Komisioni konstaton se ato duhet të miratohen për arsye të cekura më poshtë.

a. Kërkesa Nr. 00643

19. Kërkesa Nr. 00643 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, përkatësisht nënës së saj. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e të drejtës së pretenduar të pronësisë për ½ pjesë ideale të pronës së kërkuar. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin e plotfuqishëm të trashëgimisë, të vitit 2006 që tregon se bartësi i të drejtës pronësore e ka trashëguar pronën e kërkuar si bashkëpronar me ½ pjesë ideale, pas vdekjes së gjyshit të bartësit të së drejtës pronësore, Gjorgje Jovanovic. Ky vendim është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë.

20. Pala përgjegjëse pohon se është pronari i vetëm i pronës përfshirë edhe ½ pjesë ideale të kërkuar nga paraqitësi i kërkesës. Në mbështetje të pretendimeve të tij pala përgjegjëse ka paraqitur kontratën e shitblerjes, të vitit 2001, të vërtetuar në gjykatë në emër të Arife Qunit, nënës së palës përgjegjëse, si blerëse dhe Enver Qunit, i autorizuar nga Borka Orlovic dhe Plana Mandic për ¼ pjesë ideale, respektivisht, si shitës. Kontrata është vërtetuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë të vitit 2004. Në procedurën gjyqësore përkatëse në mes të Arife Qunit, nënës së palës përgjegjëse dhe Gjorgje Jovanovic, gjyshit të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, gjykata ka konfirmuar pronësinë e Arife Qunit, dhe ka konstatuar se nëna e palës përgjegjëse e ka blerë pjesën e mbetur ½ e pronës së kërkuar nga pala e tretë, Ibrahim Hasani, në vitin 1975, ndërsa i njëjti e kishte blerë atë më herët nga gjyshi i bartësit të së drejtës pronësore, Gjorgje Jovanovic në vitin 1973. Më tej, Sekretaria Ekzekutive ka gjetur certifikatën për të drejtat e pronës së paluajtshme që paraqet palën përgjegjëse si pronarin e vetëm të pronës së kërkuar. Aktgjykimi i vitit 2004 dhe certifikata për të drejtat e pronës së paluajtshme janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta.

21. Gjatë seancës së 30^{te} të mbajtur në shtator 2012, Komisioni urdhëroi që të mbahet seancë dëgjimore për këtë kërkesë nga njëri nga anëtarët e tij sipas nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Paraqitësi i kërkesës Renata Milosavljevic dhe pala përgjegjëse Hadije Quni, si dhe dy dëshmitarë të propozuar nga të dy palët, respektivisht Omer Memovic dhe Qamil Musliu, kanë marrë pjesë në seancë dëgjimore më 1 tetor 2012 në lokalet e KPA-së në Prishtinë. Në seancë dëgjimore, Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se familja e saj e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar deri në vitin 1999, dhe kjo është konfirmuar nga dëshmitarët Omer Memovic dhe Qamil Musliu. Pala përgjegjëse ka pranuar se paraqitësi i kërkesës dhe nëna e saj me të vërtetë kanë qëndruar në pronë deri në vitin 1999, por vetëm si mysafirë.

22. Komisioni konstaton se aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë i vitit 2004, sipas të cilit nëna e palës përgjegjëse e ka fituar pronësinë për ½ e pronës së kërkuar, nuk mund të konsiderohet nga Komisioni si dëshmi e mjaftueshme për këtë fakt. Komisioni konsideron se ka shumë pak mundësi që Gjorgje Jovanovic ta ketë shitur pronën në vitin 1973, por se familja e paraqitëses së kërkesës të ketë jetuar aty pandërprerë deri në vitin 1999, kur është larguar nga prona si pasojë e konfliktit. Komisioni konsideron se aktgjykimi i 2004 bazohet në përcaktimin e paplotë të fakteve përkatëse dhe për këtë arsye nuk mund të jetë bazë për këtë vendim. Pala përgjegjëse nuk ka mundur ta dëshmojë mbrojtje dhe kërkesa duhet të miratohet.

b. Kërkesa Nr 01289

23. Kërkesa nr. 01289 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës, Dragan Kosanin, ka paraqitur vendimin për ndarje të vitit 1988, të verifikuar pozitivisht, sipas të cilit prona e kërkuar i ishte ndarë paraqitësit të kërkesës, dhe kontratën e shitblerjes të vitit 1995, të verifikuar pozitivisht sipas të cilës paraqitësi i kërkesës e ka blerë pronën nga pala e tretë. Megjithëse kontrata e shitblerjes nuk e ka nënshkrimin e paraqitësit të kërkesës si blerës, ajo është e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Komisioni konsideron se kjo është dëshmi e mjaftueshme e blerjes së pronës së kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1995.

24. Komisioni vëren se dy kërkesa konkurruese janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës, Dragan Kosanin, dhe nga pala përgjegjëse Eljmi Gërguri për të njëjtën pronë në Komisionin për Kërkesa Pronësore Banesore ("HPCC"). Të dy kërkesat janë hedhur poshtë nga HPCC-ja. Megjithatë, Komisioni vëren se kur është marrë vendimi, HPCC-ja nuk e ka shqyrtuar kontratën e shitblerjes të vitit 1995 sepse paraqitësi i kërkesës nuk ia ka paraqitur atë HPCC-së.

25. Pala Përgjegjëse, Eljmi Gërguri, pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësi i kërkesës në vitin 1996. Në mbështetje të pretendimeve të tij, Pala Përgjegjëse ka paraqitur kontratën e shitblerjes të vitit 1996 dhe faturat e vitit 1996 dhe 2002, lëshuar nga ndërmarrja publike "Komunalia" për pronën e kërkuar, në emër të palës përgjegjëse, si dhe faturën e tatimit të lëshuar nga Komuna e Gllogovcit në vitin 2003. Kontrata e shitblerjes e paraqitur nga pala përgjegjëse dhe Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) ka kërkuar ekspertizë nga forenzika për të verifikuar a është ajo autentike. Ekzaminimi i kryer nga një ekspert i forenzikës në Bullgari, ka konstatuar se nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës në kontratën e pretenduar të shitblerjes nuk krahasohet me nënshkrimin e paraqitësit të kërkesës në kontratën e vërtetuar të shitblerjes të vitit 1995. Sa i përket faturave të paraqitura nga pala përgjegjëse, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur t'i verifikojë ato pasi që ato nuk ishin të regjistruara në ndërmarrjen publike përkatëse ku pretendohet se janë lëshuar. Në bisedë telefonike në mes të Sekretarisë Ekzekutive dhe palës përgjegjëse, ai deklaroi se dëshmitari i vetëm që ishte prezent kur është bërë shitblerja në vitin 1996, ishte vrarë gjatë konfliktit.

26. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se kontrata e shitblerjes e paraqitur nga pala përgjegjëse është e falsifikuar dhe se pala përgjegjëse ka filluar ta shfrytëzojë pronën e kërkuar vetëm pas konfliktit.

27. Gjatë seancës së 30^{te} të mbajtur në shtator 2012, Komisioni urdhëroi që të mbahet seancë dëgjimore për këtë kërkesë nga njëri nga anëtarët e tij sipas nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse Eljmi Gërguri janë ftuar të marrin pjesë në seancë dëgjimore më 1 tetor 2012 në lokalet e KPA-së në Prishtinë. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se deri në mars 1999 e ka vizituar rregullisht pronën e kërkuar, por më vonë nuk ka mundur ta bëjë këtë për shkak të situatës së sigurisë. Ai ka sqaruar se gjatë procedurës në HPCC ai nuk ka pasur kontratë të vërtetuar të shitblerjes përmes të cilës ai e kishte fituar pronën në vitin 1995. Pala përgjegjëse pohoi se paraqitësi i kërkesës ishte pajtuar ta shesë pronën më 29 janar 1996 dhe se me qëllim kishte nënshkruar ndryshe për ta mashtruar palën përgjegjëse.

28. Komisioni konsideron se deklaratat e paraqitësit të kërkesës gjatë seancës dëgjimore përputheshin më dokumentet para Komisionit. Në anën tjetër, deklaratat e palës përgjegjëse nuk janë mbështetur me dëshmi të besueshme. Rrjedhimisht, në bazë të dëshmive që i posedon, Komisioni konsideron që kërkesa duhet të miratohet.

c. Kërkesa nr. 48729 dhe 08711

29. Kërkesat nr. 48729 dhe 08711 janë paraqitur nga paraqitësit përkatës të kërkesave në cilësinë e anëtarëve të bashkësisë familjare të bartësve përkatës të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e bashkëpronësisë secili me nga 1/5 pjesë ideale të pronës së kërkuar. Fleta Poseduese e paraqitur nr. 78 i paraqet të dy bartësit e të drejtës pronësore si bashkëpronarë secili me nga 1/5 pjesë ideale të pronës së kërkuar. Fleta poseduese e cila paraqet tre bashkëpronarë të tjerë për pjesën e mbetur prej 3/5 pjesë ideale të pronës së kërkuar, është verifikuar si e vërtetë. Paraqitësi i kërkesës në kërkesën nr. 08711 më tej kërkon rindërtimin e pronës së dëmtuar banesore.

30. Pala përgjegjëse pohon se është njëri nga bashkëpronarët e tjerë të pronës së kërkuar në cilësinë e pasardhësit të ligjshëm të gjyshit të tij të ndjerë. Ndërkohë ai njoftoi se procedura e trashëgimisë dhe procedura për ndarjen e pronës është duke vazhduar, pala përgjegjëse nuk ka paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

31. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palës përgjegjëse, Komisioni konsideron se kërkesa duhet të aprovohet. Kërkesa për rindërtimin e shtëpisë së shkatërruar në kërkesën nr. 08711 duhet të hidhet poshtë, sepse Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat e tilla sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

d. Kërkesa Nr. 25689

32. Kërkesa nr. 25689 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, respektivisht babait të saj të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e të drejtës së pronësisë për pronën e kërkuar, një pronë banesore që gjendet në parcelën nr. 4319/2 në Gjilan. Në mbështetje të kërkesës, ajo ka paraqitur kontratën e shitblerjes të vërtetuar në gjykatë, të vitit 1966, të lidhur në mes të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore si blerës dhe Svetozar Vuckovic si shitës i pronës me sipërfaqe prej 3 ari e 40 m². Kontrata megjithatë i referohet pronës e cila gjendet në parcelën nr. 2319 dhe jo në parcelën nr. 4319/2. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar kontratën si të vërtetë. Paraqitësi i kërkesës, më tej, ka paraqitur deklaratat me shkrim ku ka sqaruar se para vitit 1966, Svetozar Vuckovic në fakt ia kishte shitur pronën e kërkuar palës së tretë respektivisht Ljuba Kitanovic. Megjithatë pasi Svetozar Vuckovic dhe Ljuba Kitanovic, në atë kohë nuk kanë lidhur kontratë formale dhe nuk janë bërë ndryshimet në regjistrat kadastrale, Ljuba Kitanovic nuk ka mundur të lidhë kontratë formale kur ka vendosur t'ia rishesë pronën e kërkuar bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore në vitin 1966. Prandaj në të regjistrat kadastrale nuk janë bërë ndryshime pas transaksionit në vitin 1966 për pronën e kërkuar, në dobi të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Përveç kësaj paraqitësi i kërkesës ka paraqitur certifikatën e vërtetuar nga Kuvendi i Komunës në Gjilan. Kjo certifikatë tregon se bartësit i pretenduar i të drejtës pronësore është autorizuar të ndërtojë objekt banimi në parcelën përkatëse. Vendimi i referohet parcelës nr. 4319/2. Paraqitësi i kërkesës sqaron se parcela nr. 4319 ishte ndarë dhe se ai kërkon vetëm të drejtën e pronësisë mbi pronën banesore e cila gjendet në parcelën nr. 4319/2.

33. Pala përgjegjëse që aktualisht jeton në pronë ka paraqitur kontratën e shitblerjes së pronës së kërkuar, të vitit 2000, të vërtetuar në gjykatë. Kjo kontratë është lidhur në mes të

palës përgjegjëse si blerës dhe Bashkim Iljazit, i autorizuar nga Svetozar Vuckovic, si shitës. Kjo kontratë është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

34. Gjatë seancës së 30^{te} të mbajtur në shtator 2012, Komisioni urdhëroi që të mbahet seancë dëgjimore për këtë kërkesë nga njëri nga anëtarët e tij sipas nenit 5.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Rrjedhimisht, sipas vendimit të Komisionit, paraqitësi i kërkesës Mladena Nikola Paunovic dhe pala përgjegjëse Isa Shaqiri janë ftuar të marrin pjesë në seancë dëgjimore dhe ata kanë ardhur më 2 tetor 2012 në lokalet e KPA-së në Prishtinë. Përveç kësaj ishte ftuar edhe dëshmitari Bashkim Ilijazi por ai nuk u paraqit në seancë dhe nuk e arsyetoi mungesën. Sekretaria Ekzekutive ka provuar t'i thërrasë gjithashtu dëshmitarët e propozuar Sinisha dhe Milanka Kitanovic por nuk ka mundur t'i kontaktojë ata. Gjatë seancës dëgjimore paraqitësi i kërkesës përsëriti pohimet e saj se pronën e kërkuar ia ka shitur Ljuba Kitanovicit para vitit 1966. Paraqitësi i kërkesës sqaroi se ajo më vonë ka kontaktuar me palën përgjegjëse për t'ia shitur pronën e kërkuar atij por nuk kanë arritur marrëveshje. Pala përgjegjëse ka deklaruar se ai e ka blerë tërë parcelën nr. 4319 në vitin 2000 për 118,000 DM.

35. Komisioni vëren se parcela nr. 2319 të cilës i referohet kontrata e shitblerjes e vitit 1966 nuk korrespondon me parcelën nr. 4319 që është lëndë e kërkesës. Megjithatë, Komisioni konsideron se ka dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar se kjo mospërputhje është pasojë e gabimit teknik. Certifikata e lëshuar nga Kuvendi i Komunës në Gjilan që autorizon paraqitësin e kërkesës të ndërtojë objekt banimi në parcelën nr. 4319/2 konfirmon pohimet e paraqitësit të kërkesës se parcela nr. 4319 është ndarë në dy parcela të veçanta dhe se ajo ishte pronare e njëres prej këtyre parcelave, pikërisht parcelës nr. 4319/2 e cila kishte të njëjtën sipërfaqe prej 3 ari e 40 m² si prona e shitur në vitin 1996 dhe që është lëndë e kësaj kërkesë. Pasi që paraqitësi i kërkesës e ka blerë pronën e kërkuar në vitet 1960 në bazë të kontratës joformale të shitblerjes, pala përgjegjëse nuk ka mundur ta blejë të njëjtën pronë nga Svetozar Vuckovic më vonë, në vitin 2000 pasi që shitësi, Svetozar Vuckovic, në atë kohë nuk ishte më pronar i pronës së kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të miratohet në emër të bartësit të së drejtës pronësore.

e. Kërkesa Nr. 34498

36. Kërkesa Nr. 34498 është paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, respektivisht babait të saj të ndjerë. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese nr. 79 të vitit 2002 në emër të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore. Certifikata për të drejtën e pronës së paluajtshme e datës 6 mars 2008 e gjetur *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive gjithashtu paraqet bartësin e pretenduar të së drejtës pronësore si pronar të ligjshëm. Për më tepër, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur certifikatën e vdekjes sipas të cilës bartësi i të drejtës pronësore ka vdekur në vitin 1980. Certifikata e vdekjes gjithashtu është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Paraqitësi i kërkesës pretendon se vëllezërit e saj Martin dhe Nikola e kanë shitur pronën e kërkuar pa dijeninë e saj dhe të motrës së saj. Ajo kërkon që KPA-ja të ndërmjetësojë në mes saj dhe vëllezërve të saj duke konfirmuar se nuk është iniciuar ndonjë procedurë trashëgimore.

37. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 2001. Në mbështetje të pretendimeve të tij, Pala Përgjegjëse ka paraqitur kontratën e shitblerjes të vitit 2001, të lidhur në mes të palës së tretë Ilmi Rrahmani, si shitës, në emër të bartësit të së drejtës pronësore që pretendon se është autorizuar nga ai dhe palës përgjegjëse në cilësinë e blerësit. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar kontratën si të vërtetë. Në bazë të kontratës së shitblerjes, të dhënat kadastrale janë përditësuar në emër të palës përgjegjëse siç dëshmohet nga certifikata për të drejtën e pronës së paluajtshme të vitit 2012. Pala përgjegjëse gjithashtu

ka paraqitur autorizimin e vitit 2001 me të cilin pretendon se e ka autorizuar Ilmi Rrahmanin ta shesë pronën e kërkuar dhe të nënshkruajë kontratën e shitblerjes. Autorizimi është vërtetuar me vulë të noterit në Republikën ish Jugosllave të Maqedonisë por vërtetësia nuk ka mundur të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive.

38. Paraqitësi i kërkesës pretendon se autorizimi i paraqitur nga pala përgjegjëse është falsifikuar nga vëllezërit e saj ndaj të cilëve ajo ka paraqitur padi në gjykatën kompetente. Pala përgjegjëse nuk ka bashkëpunuar më tej për të sqaruar rrethanat e sakta të shitblerjes.

39. Komisioni konstaton se autorizimi në fjalë nuk mund të konsiderohet si dëshmi sepse pretendohet që është lëshuar nga bartësi i të drejtës pronësore në vitin 2001, kurse ai ka vdekur në vitin 1980. Rrjedhimisht, në vitin 2001 Ilmi Rrahmani nuk ishte i autorizuar ta shesë pronën e kërkuar në emër të bartësit të së drejtës pronësore, dhe pala përgjegjëse nuk ka mundur ta fitojë pronësinë për pronën e kërkuar si rezultat i transaksionit të vitit 2001.

40. Në bazë të dëshmive që posedon, Komisioni arrin në përfundimin se kërkesa duhet të miratohet në emër të bartësit të së drejtës pronësore.

f. Kërkesa Nr. 46039

41. Kërkesa Nr. 46039 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e të drejtës së shfrytëzimit, të bartësit të së drejtës pronësore për një banesë. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur vendimin e Komunës së Prishtinës, të vitit 1978. Vendimi konfirmon pagesën e tatimit nga bartësi i të drejtës pronësore për shfrytëzimin e pronës së kërkuar banesore. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar vendimin si të vërtetë. Paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi tjera siç janë vendimi përkatës për ndarje apo kontrata për qira. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive ka konstatuar *ex officio* se bartësi i të drejtës pronësore është regjistruar në Ndërmarrjen Publike Banesore si bartës i të drejtës së shfrytëzimit të pronës së kërkuar.

42. Pala përgjegjëse i cili aktualisht e ka uzurpuar pronën e kërkuar pohon se e ka marrë posedimin e pronës së kërkuar pasi që ia ka paguar 1,500€ palës së tretë. Megjithatë, pala përgjegjëse nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që tregon se ai ka pasur ndonjë të drejtë ligjore për banesën e kërkuar e as nuk e treguar identitetin e palës së tretë. Rrjedhimisht deklarata e palës përgjegjëse nuk ka mundur të verifikohet.

43. Në këto rrethana, Komisioni konstaton se e drejta e kërkuar e shfrytëzimit duhet të miratohet në dobi të bartësit të së drejtës pronësore.

44. Në një numër kërkesash, paraqitësit e kërkesave apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, janë larguar nga prona jashtë periudhës prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999, e cila parashihet në nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka përcaktuar se, ndonëse data e largimit në këto kërkesa është jashtë periudhës së mësipërme, humbja e së drejtës pronësore në secilin rast është rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, siç kërkohet me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

45. Nga sa u tha më sipër, bazuar në dëshmitë që i posedon Komisioni konstaton se, në secilën nga kërkesat e përfshira në këtë vendim:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo mbi pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, në secilin rast, tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

B. Kërkesat për kompensim.

46. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, ky aspekt i kërkesës për kompensim duhet të hidhet poshtë.

C. Vërejtjet përmbledhëse

47. Nga sa u tha më sipër, Komisioni konstaton se kërkesat e regjistruara në pjesët A, B, C, D dhe E të listës së bashkëngjitur janë të suksesshme dhe udhëzon të nxirret urdhri sa i përket secilës kërkesë siç është dhënë më sipër.

48. Në një numër kërkesash, paraqitësi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për riposeditim të pronës së njëjtë në Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore, e cila kërkesë më pastaj ishte aprovuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC"). Komisioni konstaton se mjetet e veprimit në dispozicion të paraqitësve të kërkesave para Komisionit aktual dhe HPCC-së, respektivisht, dhe rrjedhimisht edhe juridiksionet e dy Komisioneve, nuk janë të njëjta. Kështu, vendimet e HPCC-së nuk mund të jenë domosdoshmërisht *res judicata* para Komisionit aktual, megjithatë në rrethana të caktuara mund të kemi të bëjmë me një rast të tillë. Për më tepër, në rastet kur HPCC-ja ka aprovuar urdhrin për dëbim në dobi të paraqitësit të kërkesës, Komisioni nuk konsideron se një urdhër i tillë paraqet pengesë për këtë Komision që të lëshojë urdhër të ri për dëbim në rastet kur prona është e uzurpuar në mënyrë të paligjshme.

49. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

50. Në bazë të nenit 8.5 të aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni mundet të vendosi në vendimin e tij për të drejtën pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore edhe të nxjerrë urdhër për posedimin në dobi të paraqitësit të kërkesës. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore është i gjallë, Komisioni miraton të drejtën e posedimit në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur, e vdekja është provuar por nuk është siguruar vendim i vlefshëm për trashëgiminë, Komisioni miraton posedimin për paraqitësin e kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. Në rastet kur bartësi i së drejtës pronësore ka vdekur pas depozitimit të kërkesës dhe nuk ka anëtar të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, Komisioni miraton të drejtën e posedimit për bartësin e ndjerë të

së drejtës pronësore. E drejta e posedimit miratohet në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi që rregullon marrëdhëniet familjare në Kosovë, i cili përfshin administrimin e pronës familjare si dhe duke iu referuar ligjit në fuqi për trashëgiminë. Vendimi i Komisionit për të drejtën e posedimit të pronës nga paraqitësi i kërkesës si anëtar i bashkësisë familjare nuk cenon të drejtën e anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, ose trashëgimtarëve të tjerë, të bartësit të së drejtës pronësore të cilët nuk kanë depozituar kërkesë në KPA, por të cilët mund të kenë të drejtë të përbashkët për posedimin e pronës në bazë të ligjit në fuqi ose si rrjedhojë e procedimit për trashëgiminë në të ardhmen. (neni 8.5 i aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 miratuar me Ligjin nr. 03/L-079).

51. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme e Kosovës mund të vjelë tarifën e gjyqësore për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA06558	KPA14831	KPA28301	KPA38038	KPA42330	KPA44438	KPA92721
KPA91308	KPA92754	KPA27122				

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA33399

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part C/Pjesa C/Deo C

KPA01370	KPA14533	KPA47335	KPA91530	KPA92181	KPA92182	KPA42336
----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part D/Pjesa D/Deo D

KPA34259	KPA50126	KPA40484	KPA44364	KPA92690	KPA48952	KPA48169
----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part E/Pjesa E/Deo E

KPA08711	KPA34498	KPA48729	KPA01289	KPA00643	KPA25689	
----------	----------	----------	----------	----------	----------	--

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part F/Pjesa F/Deo F

KPA46039
